



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar

Numër 3

Q E R S H O R 2 0 2 0

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve për Inflacionin

Numër 3

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: ++383 38 222 055

Fax: ++383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

Përmbajtja

Anketa e Kreditimit Bankar	7
Përmbledhja e rezultateve	7
Kutia 1. Metodologjia	10
Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe kërkesën për kredi	11
Kreditë ndaj ndërmarrjeve	11
Standardet kreditore	11
Kushtet dhe rregullat	12
Kërkesa për kredi	13
Kreditë ndaj ekonomive familjare	14
Standardet kreditore	14
Kushtet dhe rregullat	15
Kërkesa për kredi	15
Financimi	16
Rezultatet e pyetjeve të fokusuara: Ndikimet e Covid-19 në sektorin bankar	17
Pritjet për Inflacionin	19
Metodologjia	19
Përmbledhja e rezultateve	19

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

Anketa e Kreditimit Bankar

Hyrje¹

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi do të publikohet në frekuencë tremujore në webfaqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim si pasojë. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të parë të vitit 2020, dhe pritjet e bankave për dinamikën në kreditim për tremujorin e dytë të vitit 2020.

Përveç pyetjeve standarde, në këtë anketë u shtuan edhe disa pyetje mbi ndikimin potencial të masave parandaluese të ndërmarrura nga Qeveria e Kosovës kundrejt përhapjes së virusit Covid-19 mbi ofertën dhe kërkesën kreditore, si dhe ndikimin e tyre mbi pozitën e likuiditetit dhe cilësinë e portfolios kreditore të bankave.

Përmbledhja e rezultateve

Rezultatet e anketës së fundit me bankat komerciale në vend sugjerojnë që pasiguritë e rritura me shpalljen e gjendjes pandemike dhe masat parandaluese të ndërmarrura si në vend ashtu edhe në ekonominë e jashtme, kanë rezultuar në ofertë më të shtrënguar kreditore dhe zvogëlim të kërkesës për kredi gjatë tremujorit të parë të vitit. Me gjithë pasiguritë e larta që e shoqërojnë gjendjen pandemike në këtë fazë (evoluimi i virusit dhe/apo vala e dytë e përhapjes potenciale në vjeshtë), bankat kanë deklaruar të presin shtrëngim të ofertës kreditore dhe zvogëlim të kërkesës kreditore në tremujorin e dytë kundrejt tremujorit të parë të vitit 2020.

Dinamika e ngadalësuar e ritmit të rritjes së kredive për ndërmarrjet gjatë tremujorit të parë të vitit 2020, sipas anketës së kreditimit bankar, rezulton të jetë ndikuar si nga ana e ofertës kreditore, ashtu edhe nga kërkesa për kredi. Pritjet e bankave për tremujorin pasues rezultojnë të jenë edhe më pesimiste. Në linjë me këtë zhvillim stoku i kredive për korporatat jo financiare (KJF) u shtua për 31.9 milionë euro gjatë TM1 2020, përderisa gjatë TM4 2019 u shtua për 52.0 milionë euro, diferencë e ngjashme edhe nëse e krahasojmë me TM1 2019 ku stoku i kredive të KJP-ve u shtua për 52.7 milionë euro.

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kanë shtrënguar deri në një masë standardet e aplikuar gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi, për dallim nga pritjet e deklaruara në anketën e kaluar. Standardet kreditore për të dy kategoritë e ndërmarrjeve u shtrënguan deri në një masë.² Qasja më konservative e bankave kundrejt kreditimit të ndërmarrjeve i'u atribuua kryesisht masave të ndërmarrura nga Qeveria e Kosovës për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, faktor që ka ndikuar në rritjen e rrezikut të perceptuar tek bankat (ndërprerjet e tërësishme në disa aktivitete biznesore gjegjësisht tkurrja e aktivitetit të pjesës më të madhe të bizneseve të regjistruara në vend. Pasigurinë e rritur me pandeminë Covid-19 e kanë ndikuar negativisht edhe faktorë të tjerë si përkeqësimi i perspektivës së tregut në përgjithësi dhe tregut bankar vendor në veçanti, pastaj potencialisht rënia e cilësisë së portfolios kreditore, rritja e ndikimit

¹ Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1

² Shtrëngim të standardeve të aplikuar kreditore deklaruan tre nga nëntë e pjesëmarrëse në anketim.

negativ nga faktorët ndërkombëtar si perspektiva e tregut global dhe cilësia e portfolios kreditorë, si dhe pasiguritë e rritura për stabilitetin e financimit nga depozitat në tregun e brendshëm.

Për tremujorin e dytë të vitit 2020, pritjet e bankave konsistojnë me shtrëngim të mëtejme të standardeve kreditorë, pritje që kryesisht i janë atribuar rënies së pritur të aktivitetit ekonomik me izolimin si masë parandaluese kundrejt përhapjes së COVID-19, si dhe pasigurive rreth dinamikave që do të ndjekë në muajt në vijim gjendja pandemike. Gjatë TM2, numri i bankave që deklaruan të presin shtrëngim të mëtejme të standardeve kreditorë dhe në nivel më të lartë u dyfishua në gjashtë, nga gjithsej nëntë banka pjesëmarrëse në anketë. Sipas bankave, ky shtrëngim pritët të jetë më i përqendruar tek kreditë afatgjata.

Kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet u lehtësuan, megjithëse në një nivel të ulët. Mbështetja nga FKGK si dhe presioni i konkurrencës nga bankat tjera ndikuan në zbutjen e kushteve të kreditimit deri në një masë. Ndërkohë, për tremujorin e dytë 2020, bankat kanë deklaruar se presin shtrëngim deri në një masë të kushteve dhe rregullave për kreditë e reja, kryesisht përmes zvogëlimit të madhësisë së kredive dhe uljes së maturitetit për kreditë e reja. Njëkohësisht, tri nga bankat e anketuara deklaruan zvogëlim të kërkesave për kolateral. Për tremujorin e dytë të vitit 2020, kushtet dhe rregullat për kredi pritët të ndikohen negativisht nga pasiguritë e rritura rreth krizës shëndetësore dhe ekonomike dhe efekteve potenciale tek agjentët ekonomik.

Gjatë tremujorit të parë, kërkesa e ndërmarrjeve për kredi bankare rezultoi në një zvogëlim, duke rezultuar në kahje të kundërt me pritjet e deklaruara nga bankat në anketën e kaluar. Indeksi negativ që rezultoi pas indeksimit të përgjigjeve të bankave lidhur me kërkesën për kredi, i atribuohet në një masë më të lartë NVM-ve krahas ndërmarrjeve të mëdha. Në kuadër të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, bankat deklaruan se kryesisht kishte rënie të kërkesës për financimin e investimeve fikse dhe ristrukturimit të borxhit. Për më tepër, përdorimi i burimeve alternative të financimit, siç është financimi i brendshëm nga depozitat e mbajtura të ndërmarrjeve, kishte efekt deri në një masë negativ në kërkesën për kredi. Në TM2 2020, bankat presin rënie të mëtejme të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, rënie që presin ti atribuohet zvogëlimit të kërkesës për financimin e investimeve fikse. Kjo pasqyron nevojat akute të likuiditetit të ndërmarrjeve dhe pasigurinë e tyre në lidhje me ndikimin potencial të pandemisë në rënien e aktivitetit dhe për pasojë të kërkesës për financim të investimeve fikse. Njëkohësisht, bankat presin rënie të dukshme në cilësinë e aplikacioneve për kredi nga ndërmarrjet.

Dinamikat e aktivitetit kreditues për ekonomitë familjare gjatë periudhës raportuese, sipas anketës, u ndikuan negativisht nga kërkesa për kredi, përderisa oferta kreditorë mbeti e pandryshuar për këtë segment. Standardet kreditorë të aplikuara për ekonomitë familjare, sipas anketës, rezultojnë të kenë mbetur të pandikuara përballë gjendjes së krijuar me pandeminë në tremujorin e parë 2020. Megjithatë, pritjet e bankave për TM2 2020 japin indikacione për shtrëngim të theksuar të standardeve kreditorë për segmentin e ekonomive familjare, në veçanti për kreditë për blerjen e shtëpive, si pasojë e pasigurive të rritura për prospektet e ardhshme dhe maturitetin e gjatë të këtyre kredive. Bankat presin shtrëngim të standardeve kreditorë edhe për kreditë konsumuese, mirëpo në një nivel më të ulët për dallim nga kreditë për blerjen e shtëpive. Këto pritje u bazuan në rritjen e ndjeshmërisë së bankave ndaj rrezikut si pasojë e pandemisë.

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për segmentin e ekonomive familjare u lehtësuan deri në një masë, kryesisht përmes ofrimit të normave më të favorshme të interesit, rritjes së shumës së kredisë së aprovuar dhe kërkesave më të volitshme për kolateral. Rritja e presioneve të konkurrencës nga sektori bankar, si dhe perspektiva e favorshme e tregut bankar në vend dhe perspektiva e mirë e tregut të patundshmërive, rezultojnë të kenë qenë faktor kyç në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të kreditimit për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të parë të vitit 2020. Për tremujorin e dytë të vitit 2020, bankat presin shtrëngim deri në një masë të kushteve dhe rregullave për kredi, në veçanti

për kreditë për blerjen e shtëpive. Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja ndaj ekonomive familjare pritet të ndikohen negativisht nga rritja e rrezikut të perceptuar nga ana e bankave (perspektiva jo e kënaqshme për tregun në vend dhe jashtë tij, perspektiva jo e mirë në tregun e patundshmërive, pasiguria në aftësinë paguese të klientëve dhe rreziku më i lartë i kolateralit), përkeqësimi i cilësisë së portfolios kreditorë brenda dhe jashtë vendit, si dhe në një masë më të ulët, pozita jo e kënaqshme e likuiditetit. Të gjithë faktorët e lartpërmendur u nxitën nga ndikimi i pandemisë në aktivitetin ekonomik në Kosovë dhe ekonominë e jashtme. .

Megjithëse masat për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 u ndërmorën vetëm në dy javët e fundit të këtij tremujori, kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare rezultoi të jetë ndikuar deri në një masë. Në këtë tremujor, bankat raportuan rënie të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, një rënie më e theksuar tek kreditë për blerje të shtëpive kundrejt kërkesës për kredi konsumuese. Bankat raportuan se rënia e kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare i është atribuar rënies së kërkesës për financim të konsumit, rënies së kërkesës për ristrukturim të borxhit dhe në një masë më të vogël, nga perspektiva jo e kënaqshme e tregut të patundshmërive. Në tremujorin e dytë të vitit 2020, bankat presin rënie të theksuar të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, me rënie më të theksuar në kërkesën për kredi për blerje të shtëpive, përderisa kërkesa për kredi konsumuese pritet të ketë rënie në një nivel më të ulët. Rezultatet e anketës sugjerojnë se pritjet e bankave për dinamikat në kërkesën për kredi kryesisht mbështeten në perspektivën jo të favorshme në tregun për patundshëmri, rënien e besueshmërisë së klientëve për aftësinë e ripagimit të kredive dhe rënien e kërkesës për financimin e konsumit.

Pasiguritë e larta rreth prospekteve ekonomike, si pasojë e krizës shëndetësore dhe mbylljes së aktiviteteve biznesore rezultuan në rritje të rrezikut kreditor. Bankat deklaruan rritje deri në një masë të kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në tremujorin e parë të 2020, indikator ky që pritet të përkeqësohet tutje në tremujorin e dytë të vitit 2020.

Bankat deklaruan për rënie të lehtë të gjithsej financimit në periudhën raportuese, të ndikuar nga tërheqja e depozitave të ndërmarrjeve, që nënkupton mbulimin e mungesave të likuiditetit përmes depozitave të mbajtura në banka, duke marrë parasysh pasiguritë në realizimin e të hyrave. Përderisa, depozitat nga ekonomitë familjare vazhduan të mbështesin financimin e aktiviteteve bankare. Gjatë tremujorit të ardhshëm, bankat presin rënie të mëtutjeshme të qasjes në financim. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të ulet krahasuar me TM1 2020, si dhe financimi nga depozitat e ndërmarrjeve pritet të vazhdojë rënien. Për dallim nga tremujori i parë 2020, në tremujorin e ardhshëm dy nga bankat e anketuara presin mbështetje në financim të aktivitetit nga institucionet financiare ndërkombëtare, përderisa si pasojë e karakterit global të pandemisë Covid-19, bankat përgjithësisht nuk presin ndryshime në financimin nga bankat amë.

Kutia 1. Metodologjia

Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar

Pyetësi i AKB është i bazuar në format e standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore në eurozonë dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKB është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKB përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën kreditore, ndryshimet në kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjes në financim të sektorit bankar. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe ndryshimeve të pritura gjatë tre muajve të ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen.

Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKB mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohe më të gjatë. Në anketim marrin pjesë nëntë nga dhjetë bankat që operojnë në Kosovë. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithsej sektorit bankar dhe 99.8 përqind të gjithsej kreditimit në sektorin bankar.

Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimit apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit.

Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej - 0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim / rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithsej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë.

Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.

Pyetësi, si dhe seria kohore e rezultateve të AKB, janë në dispozicion në faqen e internetit të BQK-së, nën vegëzen e Anketës së Kreditimit Bankar.


Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe kërkesën për kredi

Kreditë ndaj ndërmarrjeve

Standardet kreditore

Standardet kreditore (udhëzimet e brendshme të bankave apo kriteret për aprovimin e kredive) të aplikuara për ndërmarrjet në përgjithësi u shtrënguan deri në një masë gjatë tremujorit të parë të vitit 2020, të përkthyer në indeks të ulët negativ, prej 0.15 (indeks pozitiv prej 0.14 në TM4 2019). Në anketën e kaluar (TM4 2019), bankat kishin deklaruar pritjet e tyre për standarde kreditore të pandryshuara në TM1 2020 (grafiku 1).

Grafik 1. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuon



Burimi: BQK.

Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, standardet kreditore u shtrënguan si për ndërmarrjet e mëdha ashtu edhe për NVM-të. Tri nga bankat e anketuara deklaruan shtrëngim deri në një masë për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, duke rezultuar në indeks negativ prej 0.21 për NVM-të dhe indeks negativ prej 0.24 për ndërmarrjet e mëdha.

Rol kryesor në shtrëngimin e standardeve të aplikuara nga bankat në TM1 2020, rezulton të kenë luajtur masat e ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, ku pjesa më e madhe e bankave raportuan kontribut negativ edhe pse këto masa i ndikuan bankat vetëm në dy javët e fundit të tremujorit në fjalë. Masave të implementuara, pas indeksimit të përgjigjeve të bankave, iu atribua një indeks negativ prej 0.56. Për më tepër, këto masa përshkallëzuan edhe kontributin e faktorëve tjerë në shtrëngim të standardeve kreditore. Rrjedhimisht, bankat perceptuan rrezik të rritur si pasojë e pasigurive në perspektivën e tregut të brendshëm në përgjithësi, si dhe në perspektivën e tregut bankar vendor. Po ashtu, bankat deklaruan rritje të rrezikut kreditor, rritje të rrezikut nga faktorët ndërkombëtar (si pasojë e pasigurive të shtuara në tregjet ndërkombëtare), si dhe në masë më të ulët bankat deklaruan rrezik nga rënia e financimit nga burimet brenda vendit. Faktori i vetëm me ndikim pozitiv në standardet kreditore ishte mbështetja nga FKGK. Norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet shënoi rënie në këtë periudhë, mirëpo shkalla e rënies ishte dukshëm më e ulët se ajo në standardet kreditore.

Bankat pritjet t'i shtrëngojnë edhe më tutje standardet kreditore në TM2 2020, duke u bazuar në pritjet për vështirësi të shumta për ndërmarrjet që operojnë në sektorë të caktuar të prekur nga masat për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 (ngrirjes së aktivitetit ekonomik, rënies së kërkesës, ndërprerjes së rrugëve të furnizimit, etj.), si dhe mundësisë së reflektimit të këtyre vështirësive edhe gjatë gjysmës së dytë të vitit 2020. Bankat presin që masat e ndërmarra për parandalimin e përhapjes së Covid-19 të reflektohen në rritjen e perceptimit të rrezikut, përkeqësimin e cilësisë së portfolios

kreditore, vështirësi në financimin e aktiviteteve të bankës, tolerancë dukshëm më të ulët ndaj rrezikut dhe ndikim negativ nga faktorët ndërkombëtar. Faktori i vetëm që bankat presin të ndihmoj në një ofertë të favorshme, e që në këtë situatë është shumë e nevojshme, është mbështetja nga FKGK e NVM-ve.


Konkretisht, gjashtë nga bankat e përfshira në anketë deklaruan se presin t'i shtrëngojnë standardet kreditore me një indeks negativ prej 0.52, shifër shumëfishë më e lartë se në tremujorin e parë. Standarde kreditore të shtrënguara pritet të aplikohen si për NVM-të (indeks negativ prej 0.59) ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha (indeks negativ prej 0.51). Njëkohësisht, bankat pritet të kenë ofertë tejet të shtrënguar për kreditë afatgjata (indeks negativ prej 0.52), si pasojë e pasigurisë në lidhje me ndikim e pandemisë.

Në linjë me pritjet për standardet kreditore, norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet pritet të ulet konsiderueshëm, saktësisht për NVM-të me një indeks negativ prej 0.61, për ndërmarrjet e mëdha me një indeks negativ prej 0.56, e po ashtu sa i përket maturitetit norma e aprovimit të kredive afatgjata pritet të ulet me një indeks negativ prej 0.63.

Kushtet dhe rregullat

Në TM1 2020, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet (kushtet dhe rregullat përkatëse të një kontrate të caktuar për kredi) u lehtësuan margjinalisht (grafiku 2). Konkretisht, lehtësim deri në një masë kishte në kërkesat për kolateral (indeks pozitiv prej 0.20) dhe lehtësim margjinal për maturitetin e kredive të reja (indeks pozitiv prej 0.10). Këto ndryshime i atribuohen kryesisht kushteve dhe rregullave për NVM-të, ngase në rastin e ndërmarrjeve të mëdha nuk kishte ndryshim.

Grafik 2. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet



Faktorët që ndikuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave ishin kryesisht mbështetja nga FKGK me një indeks prej 0.24 dhe presioni i konkurrencës nga bankat tjera në vend me një indeks më të ulët prej 0.19. Përkundër që nuk është reflektuar në kushtet dhe rregullat e aplikuara, bankat kanë rreshtuar si faktor me kontribut negativ masat e ndërmarra për parandalimin e përhapjes së Covid-19, që për pasojë u reflektuan në perspektivën jo të favorshme të tregut bankar si në vend ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, si dhe përkeqësimin e cilësisë së portfolios kreditore në vend dhe jashtë tij.

Si pasojë e pasigurive të perceptuara nga bankat për TM2 2020, bankat pritet të kenë ofertë kreditore deri në një masë më konservative për ndërmarrjet duke u bazuar në kushtet dhe rregullat e ofruara. Në këtë kontekst, bankat deklaruan që do të kufizojnë madhësinë dhe maturitetin e kredive të aprovuara për të dy kategoritë e ndërmarrjeve. Gjithashtu, tri prej bankave pritet të kenë kërkesa më të favorshme për kolateral për të dy kategoritë e ndërmarrjeve.

Koncentrimi i masave për parandalimin e përhapjes së Covid-19 kryesisht gjatë tremujorit të dytë pritet të ndikojë në përkeqësimin e perspektivës së tregut bankar brenda dhe jashtë vendit, në rritje të rrezikut kreditor, vështirësi në sigurimin e financimit nga depozitat dhe në uljen e tolerancës së bankave ndaj rrezikut. Këto pritje janë faktorët që pritet të kontribuojnë në shtrëngimin e kushteve dhe rregullave për ndërmarrjet.


Kërkesa për kredi

Gjatë tremujorit të parë, kërkesa për kredi nga ana e ndërmarrjeve shënoi rënie të dukshme edhe pse kjo rënie u koncentrua vetëm në dy javët e fundit të tremujorit në fjalë. Saktësisht, kërkesa për kredi nga NVM-të u tkurr në nivel më të lartë me një indeks negativ prej 0.51, ndërsa ajo nga ndërmarrjet e mëdha u tkurr me një indeks negativ prej 0.33. Ngrirja e veprimtarive ekonomike të shumë sektorëve të ndërmarrjeve, e rrjedhimisht, edhe pasiguria për aftësinë e tyre për kthimin e kredive dhe plotësimin e kriterëve për marrjet e kredive ndikuan në rënie të kërkesave për kredi nga ndërmarrjet.

Sipas anketës, rënia e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet në masë më të madhe u ndikua nga kërkesa e zvogëluar për financimin e investimeve fikse (indeks negativ prej 0.39) dhe deri në një masë nga zvogëlimi i kërkesës për financimin e inventarëve dhe kapitalit (indeks negativ prej 0.16). Njëkohësisht, bankat deklaruan për rënie të kërkesës për ristrukturim të borxheve nga ndërmarrjet me indeks negativ 0.25.

Sipas bankave, cilësia e aplikacioneve të pranuar mbeti pothuajse e pandryshuar. Megjithatë, për herë të parë që nga anketa e realizuar në shtator të vitit 2015, bankat deklaruan rritje të raportit të kredive jo-performuese me një indeks pozitiv prej 0.11 në tremujorin e parë të vitit 2020, kundrejt rënies që shënoi ky indikator në TM4 2019 me një indeks negativ prej 0.36.

Grafik 3. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Përgjatë tremujorit vijues pritet ngrirje e aktivitetit apo aktivitet i kufizuar për një pjesë të madhe të ndërmarrjeve si pasojë e masave të ndërmarrja për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19. Këto pritje u pasqyruan në parashikimet e bankave për ndryshimet në kërkesën për kredi gjatë TM2 2020. Rrjedhimisht, kërkesa pritet të zvogëlohet konsiderueshëm si nga NVM-të (indeks negativ prej 0.65) ashtu edhe nga ndërmarrjet e mëdha (indeks negativ prej 0.63). Rënia e kërkesës për kredi pritet të ndikohet nga rënia e kërkesës së ndërmarrjeve për financimin e investimeve fikse. Pavarësisht vështirësive në aktivitetin e ndërmarrjeve në TM2 2020, kërkesa për ristrukturim të borxhit nuk u reflektua si faktorë me ndikim në rënie të kërkesës për kredi, për shkak të vendimit të marrë nga BQK për pezullimin e përkohshëm të pagesës së kësteve të kredive për klientët e prekur nga masat në fuqi. Pjesëmarrja e ndërmarrjeve në aplikimet për pezullimin e pagesës së kësteve të kredive deri në mars ishte 71.5 përqind e gjithsej aplikimeve, apo 30.3 përqind e gjithsej stokut të kredive.

Konform vështirësive të hasura nga ndërmarrjet, bankat presin përkeqësim të theksuar të cilësisë së aplikacioneve për kredi nga ndërmarrjet me një indeks negativ prej 0.40 për NVM-të dhe indeks negativ prej 0.30 për ndërmarrjet e mëdha.

Bankat presin që raporti i kredive jo-performuese të përkeqësohet edhe më tutje në TM2 2020 me një indeks pozitiv prej 0.36, që nënkupton rritje të kredive jo-performuese.


Kreditë ndaj ekonomive familjare

Standardet kreditore

Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 mbetën përgjithësisht të pandryshuara krahas tremujorit paraprak. Megjithëse pritjet e bankave të anketuara në tremujorin e fundit të vitit 2019 sugjeronin për lehtësim të standardeve të aplikuara në masë më të lartë për tremujorin e parë të këtij viti, veçanërisht për kreditë konsumuese, rezultatet e anketës së TM1 2020 sugjerojnë të kundërtën (grafiku 4). Njëkohësisht, bankat deklaruan të kenë ulur normën e aprovimit të kredive për ekonomitë familjare për kredi për blerjen e shtëpive, ndërsa norma e aprovimit për kreditë konsumuese mbeti pothuajse e pandryshuar.

Masat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për mbylljen/pezullimin apo zvogëlimin e aktivitetit në sektor të caktuar ekonomik me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë ndikuan vetëm dy javët e fundit të tremujorit të parë, gjë që nuk u reflektua në ndryshim të standardeve kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare. Rrjedhimisht, standardet kreditore për ekonomitë familjare gjatë këtij tremujori mbetën përgjithësisht të pandryshuara. Megjithatë, masat e ndërmarra nga Qeveria për parandalim të përhapjes së pandemisë u përkthyen në rritje të rrezikut të perceptuar të tregut në përgjithësi, të aftësisë paguese të klientëve dhe të rënies potenciale të cilësisë së portofolios kreditore. Rritja e presioneve të konkurrencës ishte i vetmi faktor me kontribut pozitiv në standardet kreditore.

Grafik 4. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Burimi: BQK.


Në tremujorin e dytë 2020, kryesisht si pasojë e goditjes së ekonomisë nga masat e ndërmarra në funksion të parandalimit të përhapjes së pandemisë, bankat presin standarde kreditore dukshëm të shtrënguara për ekonomitë familjare me një indeks prej 0.46. Standardet kreditore pritjet të shtrëngohen në një nivel më të lartë për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese, indeks negativ prej 0.43 dhe 0.31, respektivisht, si pasojë pasigurisë më të lartë që mund të bartin si investime. Në linjë me këtë, bankat deklaruan se presin standarde kreditore të shtrënguara për kreditë afatgjata më një indeks negativ prej 0.46. Pritjet për standardet kreditore të shtrënguara gjatë TM2 2020 janë bazuar në ndikimin e masave për përmbajtjen e përhapjes së virusit Covid-19, të cilat pritjet ndër tjerash të reflektohen në përciptim të rritur të rrezikut përmes perspektivës jo të

favorshme të tregut në përgjithësi, perspektivës jo të favorshme të tregut të patundshmërive dhe pasigurisë në aftësinë e klientëve për kthimin e kredive. Bankat gjithashtu presin që rritja e rrezikut kreditor dhe ulja e theksuar e tolerancës së bankave ndaj rrezikut të kenë kontribut negativ në standardet kreditore gjatë tremujorit të ardhshëm (TM2 2020). Njëkohësisht, bankat presin rënie të theksuar të nivelit të aprovimit të kredive si për blerjen e shtëpive, ashtu edhe për kreditë konsumuese, me indeks negativ prej 0.53 dhe 0.34, respektivisht.

Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja ndaj ekonomive familjare përgjithësisht u lehtësuan në tremujorin e parë të vitit 2020, edhe pse në nivel të ulët. Lehtësimi ishte i ngjashëm si për kreditë konsumuese, ashtu edhe për ato për blerje të shtëpive. Kryesisht, kushtet dhe rregullat u lehtësuan përmes zvogëlimit të normave të interesit (indeks pozitiv prej 0.13 për kreditë për blerjen e shtëpive dhe 0.10 për kreditë konsumuese), rritjes së shumës së aprovuar (kryesisht për kreditë konsumuese me indeks pozitiv 0.13) dhe uljes së kërkesave për kolateral (indeks pozitiv prej 0.13 për të dy llojet e kredive) (grafiku 5).

Grafik 5. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Faktorët që kontribuuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të aplikuara janë kryesisht rritja e presioneve të konkurrencës nga sektori bankar, perspektiva e favorshme e tregut bankar në vend, si dhe në një masë më të vogël, perspektiva e mirë në tregun e patundshmërive.


Për tremujorin e dytë të vitit 2020, bankat deklaruan se do të shtrëngojnë deri në një masë kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare. Bankat pritet të shtrëngojnë kushtet dhe rregullat kryesisht për kreditë për blerjen e shtëpive, e ndikuar nga pasiguria që bartin si ekspozime me afat të gjatë maturimi. Konkretisht, bankat pritet të zvogëlojnë madhësinë e kredive të aprovuara, të ulin afatin e maturitetit, dhe në një masë më të ulët, të rrisin kërkesat për kolateral. Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja ndaj ekonomive familjare pritet të ndikohen negativisht nga rritja e rrezikut të perceptuar nga ana e bankave si pasojë e perspektives jo kënaqshme për tregun në vend dhe jashtë tij, perspektives jo të mirë në tregun e patundshmërive, pasigurisë në aftësinë paguese të klientëve dhe rrezikut më të lartë të kolateralit. Për më tepër, bankat deklaruan se presin që kjo situatë të ndikojë edhe në rritjen e rrezikut kreditor, si dhe, pesë nga bankat e anketuara presin të përballen edhe me një pozitë jo të favorshme të likuiditetit.

Kërkesa për kredi

Në tremujorin e parë të vitit 2020, bankat raportuan për rënie të kërkesës për kredi nga segmenti i ekonomive familjare. Edhe pse masat për përmbajtjen e përhapjes së virusit Covid-19 ndikuan vetëm dy javët e fundit të këtij tremujori, pasiguritë e rritura u reflektuan në kërkesë më të ulët për kredi bankare në katër nga bankat e anketuara. Kryesisht, rënie më të theksuar të kërkesës kishte për

kreditë për blerjen e shtëpive me indeks negativ prej 0.38, përderisa rënia për kredi konsumuese ishte marginale me indeks negativ prej 0.08. Situata aktuale del të ketë diferencë të theksuar nga ajo çfarë kanë pritur bankat për periudhën e njëjtë, të raportuar në anketën e kaluar (grafiku 6).

Grafik 6. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuon



Kjo rënie i'u atribua deri në një masë kërkesës më të ulët për financim të konsumit, rënies së kërkesave për ristrukturim të borxhit dhe në një masë më të vogël, nga perspektiva jo e kënaqshme e tregut të patundshmërive. Rënia e kërkesave për ristrukturim të borxhit reflekton vendimet në fuqi për pezullimin e përkohshëm për pagesën e kësteve të kredive, për të mundësuar menaxhim më efikas të goditjes potenciale të sektorit bankar nga kriza ekonomike. Pjesëmarrja e ekonomive familjare në aplikimet për pezullimin e pagesës së kësteve të kredive deri në Mars ishte 28.5 përqind e gjithsej aplikimeve, apo 12.1 përqind e gjithsej stokut të kredive. Cilësia e aplikacioneve të pranuar mbeti e pandryshuar për të dy kategoritë e kredive për ekonomitë familjare. Përderisa, bankat deklaruan për herë të parë që nga anketa e realizuar në shtator të vitit 2015, rritje të raportit të kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ekonomitë familjare me një indeks pozitiv prej 0.17.

Në tremujorin e dytë të vitit 2020, bankat presin rënie të konsiderueshme të kërkesës si pasojë e vështirësive në realizimin e të ardhurave me të cilat po përballen një pjesë e madhe e ekonomive familjare, e sidomos gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020. Bankat deklaruan se presin rënie të konsiderueshme në veçanti të kërkesës për kredi për blerjen e shtëpive (indeks negativ prej 0.72), raportuar nga gjashtë banka pjesëmarrëse në anketim, ndërsa rënia e kërkesës për kredi konsumuese u shpreh me një indeks negativ prej 0.53. Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat ia atribuon këto pritje perspektivës jo të favorshme në tregun për patundshmëri, rënies së besueshmërisë së klientëve për aftësinë e ripagimit të kredive dhe rënies së kërkesës për financimin e konsumit.

Njëkohësisht, bankat deklaruan se presin përkeqësim të cilësisë së aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare. Saktësisht, pritjet për cilësinë e aplikacioneve për kredi konsumuese kishin një indeks negativ prej 0.22, ndërsa për kreditë për blerjen e shtëpive kishin indeks negativ prej 0.19.

Bankat presin rritje të theksuar të raportit të kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive të ekonomive familjare, në tremujorin e dytë të vitit 2020, me një indeks pozitiv prej 0.36.

Financimi


Bankat raportuan rënie të lehtë të qasjes në financim në Kosovë gjatë tremujorit të parë të vitit 2020. Duke marrë parasysh modelin tradicional të sektorit bankar në Kosovë ku financimi dominohet nga depozitat e ekonomive familjare dhe të ndërmarrjeve, rreziku për zvogëlimin potencial të të hyrave të realizuara nga bankat si pasojë e rënies potenciale të nivelit të depozitave është rritur.

Rezultatet e anketës tregojnë që financimi i bankave gjatë tremujorit të parë të 2020 u ndikua negativisht nga depozitat e ndërmarrjeve, me një indeks negativ prej 0.24, përderisa depozitat e

ekonomive familjare vazhduan ta mbështesin financimin e sektorit bankar me një indeks pozitiv prej 0.27 (grafiku 7). Një nga bankat e anketuara deklaroi rritje të financimit deri në një masë edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare, dhe një bankë tjetër deklaroi mbështetje të financimit nga banka amë. Sipas maturitetit, indeksi ishte i ulët edhe për depozitat afatshkurtra edhe për ato afatgjata në këtë tremujor, saktësisht indeks negativ prej 0.04 dhe 0.09, respektivisht.

Për tremujorin e ardhshëm, bankat presin rënie të mëtutjeshme të qasjes në financim. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të ulët për dallim nga TM1 2020 (indeks negativ prej 0.15), ndërsa financimi nga ana e depozitave të ndërmarrjeve pritet të vazhdojë rënien (indeks negativ prej 0.26). Në tremujorin e dytë, dy banka presin mbështetje në financim të aktivitetit të bankar nga institucionet financiare ndërkombëtare, prej tyre njëra me rëndësi sistemike. Përderisa, si pasojë e karakterit global të pandemisë Covid-19, bankat deklaruan se nuk presin ndryshime në financimin nga bankat amë. Sipas maturitetit, në tremujorin e ardhshëm indeksi rezulton negativ si për depozitat afatshkurtra ashtu edhe për ato afatgjata, saktësisht indeks negativ prej 0.26 dhe 0.20, respektivisht (grafiku 7).

Grafik 7. Ndryshimet në financimin e sektorit bankar



Rezultatet e pyetjeve të fokusuara: Ndikimet e Covid-19 në sektorin bankar

Pyetëtori i dërguar tek bankat për tremujorin e parë 2020 është plotësuar me tri pyetje shtesë, me qëllim të vlerësimit të reagimit të bankave ndaj situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 përmes ofertës kreditore si dhe perceptimit të tyre sa i përket sjelljes së klientëve në aspekt të kërkesës për kredi. Gjithashtu, pyetjet adresojnë edhe ndikimin e masave për përmbajtjen e përhapjes së virusit Covid-19 në likuiditetin e bankave dhe cilësinë e portfolios kreditore.

Bankat deklaruan se gjatë tremujorit të parë, nuk ndërmorën masa të konsiderueshme në aspekt të ofertës kreditore, mirëpo një pjesë e madhe e bankave potencuan se në dy javët e fundit të muajit Mars shqyrtimi i kërkesave për kredi, që nënkupton analizimin e pozitës financiare të klientëve, u bë me kujdes të shtuar. Për më tepër, bankat zvogëluan apo pezulluan përkohësisht kreditimin e sektorëve më të ekspozuar ndaj masave për përmbajtjen e përhapjes së Covid-19 (siç janë gastronomia dhe ndërtimtaria), përderisa qasje selektive në kreditim të sektorëve ekonomik pritet të aplikojnë edhe në tremujorin e dytë të vitit. Sa i përket kreditimit të ekonomive familjare një nga bankat deklaroi se kanë ndaluar kreditimin e punonjësve të sektorit privat përderisa për punonjësit e sektorit publik kërkesat për financim po shqyrtohen me kujdes të shtuar. Pjesa më e madhe e bankave deklaruan se tremujori i parë kryesisht u karakterizua me shqyrtimin dhe implementimin e pezullimit të përkohshëm të pagesës së kësteve të kredive aktuale. Njëkohësisht, diferenca në përgjigjet e bankave nxjerr në pah pasigurinë e lartë në lidhje me ndikimin e pandemisë Covid-19 dhe pikëpamjeve të ndryshme të bankave në lidhje me ndikimin që ka në ofertën kreditore.

Sa i përket, pyetjes së dytë, mbi sjelljen e klientëve të reflektuar në kërkesën për kredi, bankat deklaruan se efekti i masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19 u vërejt qysh me fillimin e implementimit të tyre duke rezultuar në një kërkesë të ulët. Bankat presin rënie të konsiderueshme të kërkesës së ndërmarrjeve për financimin e investimeve kapitale, ndërsa edhe kërkesa e tanishme e ndërmarrjeve për sigurim të likuiditetit, në të ardhmen mund të bie bazuar në uljen e nivelit të aktivitetit që do të kenë për shkak të masave parandaluese në fuqi. Sjellje e ngjashme pritet edhe nga ana e ekonomive familjare për shkak të pasigurive për punësim, në sigurimin e të ardhurave dhe kohëzgjatjen e pandemisë. Për tremujorin e dytë të 2020, pjesa më e madhe e bankave parashih përshkallëzim të rënies të kërkesës për kredi, madje një nga bankat deklaroi se rënia e pritur në kreditim është cilësuar si më e lartë se sa rënia e kërkesës gjatë krizës financiar të vitit 2008. Përderisa, dy nga bankat presin përmirësim të kërkesës për kredi duke parashikuar përfundimin e krizës së pandemisë gjatë tremujorit të dytë të 2020.

Pyetja e tretë, mbi ndikimin e krizës së pandemisë në likuiditet, bankat deklaruan se përveç tërheqjeve si pasojë e panikut në fillim të implementimit të masave, niveli i likuiditetit në sektorin bankar qëndroi stabil e po ashtu bankat kanë ndërmarr masat për sigurimin e likuiditetit gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, pjesa më e madhe e bankave potencuan që kohëzgjatja e pandemisë luan një rol kyç në menaxhimin e suksesshëm të likuiditetit, për shkak që zgjatja e pandemisë do të ndikoj negativisht BPV-në, aktivitetin ekonomik, papunësinë, çmimet, sektorin e tregtisë dhe elemente të tjera, rrjedhimisht ky ndikim do të përkthehet në tërheqje të depozitave. Për më tepër, zgjatja e pandemisë do të ndikoj që të hyrat e bankave të jetë më e ulëta si pasojë e shtyrjes së ripagimit të kredive, përderisa në anën tjetër dalja e mjeteve nga bankat do të jetë më e lartë për shkak të tërheqjes së depozitave nga klientët për mbulimin e shpenzimeve.

Sa i përket ndikimit të pandemisë në cilësinë e portfolios kreditore, bankat deklaruan se masa e ndërmarr për pezullimin e përkohshëm të pagesës së kësteve të kredive ka ndihmuar deri në një masë për të mbajtur nën kontroll cilësinë e portfolios kreditore, mirëpo për tremujorët e ardhshëm të vitit 2020, zgjatja e krizës së pandemisë pritet të përcillet me përqësimit të cilësinë së kredive për shkak të aktivitetit të ulët ekonomik.

Pritjet për Inflacionin

Me qëllim të avancimit të kapaciteteve analitike dhe duke u bazuar në praktikat më të mira rajonale dhe më gjerë, BQK ka vazhduar me anketimin e institucioneve financiare në vend, duke u mbështetur në hipotezën se institucionet financiare bartin praktikat më të mira nga bankat amë dhe kanë ekspertizën e duhur për të projektuar dinamikat e inflacionit. Si rezultat, nga tremujori i tretë i vitit 2019, AKB është pasuruar edhe me pyetje shtesë, që adresojnë pritjet e bankave komerciale për zhvillimet në çmime në vend, duke ndihmuar kështu dhe plotësuar analizat tona në aspektin e analizimit, modelimit dhe parashikimit.

Në pyetësorin e fundit të realizuar në prill 2020, përveç deklaramentit të bankave lidhur me vlerësimet që kanë për nivelin e inflacionit në tremujorin e parë të vitit 2020, pyetësori adreson edhe pritjet e bankave për tremujorin e dytë dhe për vitin 2020 në përgjithësi. Anketa shërben gjithashtu edhe si një mjet për identifikimin e faktorëve specifik që potencialisht mund të ndikojnë pritjet e bankave për nivelin e caktuar të inflacionit.

Duke marr parasysh që anketa mbi pritjet e bankave për nivelin e inflacionit është në fazën fillestare të implementimit, seria kohore në dispozicion është e kufizuar dhe nuk mundëson analiza krahasuese në këtë fazë.

Metodologjia

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivitetit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore.

Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e lartë për vendet të cilat e kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, ndër të tjera, shërbejnë edhe si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse besohet se banka qendrore do të reagojë për të arritur objektivin, atëherë edhe pritjet e agjentëve ekonomik lidhur me shkallën e inflacionit do të ishin më pranë objektivitetit. Pritjet e inflacionit janë të rëndësishme edhe për bankat të cilat nuk posedojnë politikë monetare, duke qenë se shërbejnë si input i rëndësishëm në përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe në procesin e modelimit dhe parashikimit. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë kërkesën agregate, që më pas ndikon ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Ndër më të përdorurat është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. Banka Qendrore e Kosovës, për herë të parë ka filluar me vlerësimin e pritjeve për inflacionin duke filluar nga tremujori i tretë i vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale dhe në të ardhmen pritet të zgjerohet edhe me agjent të tjerë ekonomik.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore të shoqëruara edhe me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore, fillimisht pritjet për tërë vitin aktual, shoqëruar edhe me vlerësimet për tremujorin paraprak si dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale. Analiza e pritjeve të inflacionit pritet të jetë pjesë e raporteve të rregullta të BQKsë.

Përmbledhja e rezultateve

Bazuar në anketën e realizuar në prill të vitit 2020, shumica e bankave presin që inflacioni do të jetë më i ulët në vitin 2020 krahasuar me vitin e kaluar. Edhe për tremujorin e parë të vitit 2020, bankat deklaruan nivel më të ulët të inflacionit krahasuar me tremujorin paraprak. Mesatarisht, bankat

presin që inflacioni do të jetë 1.4 përqind në vitin 2020, krahasuar me 2.7 përqind sa ishte në vitin 2019 (tabela 1). Anketa e realizuar në prill përfshinë edhe pritjet e bankave rreth efekteve potenciale të krizës ekonomike si pasojë e pandemisë në dinamikat e çmimeve.

Tabela 1. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	2020	TM1 2020	TM2 2020
1	0.7%	0.3%	1.0%
2	2.2%	0.9%	1.2%
3	2.5%	2.6%	2.4%
4	-0.6%	-0.2%	1.1%
5	1.8%	0.5%	0.7%
6	0.9%	1.0%	1.1%
7	2.0%	2.1%	2.1%
8	1.3%	2.4%	1.7%
9	1.4%	0.5%	0.7%
Mesatarja	1.4%	1.1%	1.3%


Burimi: Bankat komercial dhe kalkulumet e BQK-së.

Të dhënat e publikuara nga Agjensia e Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2019, sugjerojnë se inflacioni ishte rreth 2.7 përqind, që është nivel i përafërt me pritjet e bankave. Në anketën e realizuar me bankat komerciale për tremujorin e kaluar, vlerësimet e bankave kanë qenë se niveli i inflacionit do të jetë rreth 1.1 përqind në tremujorin e parë 2020. Të dhënat aktuale për këtë tremujor sugjerojnë se niveli i inflacionit ishte 1.1 përqind, që është i njëjtë me pritjet e bankave. Sa i përket tremujorit të dytë të vitit 2020, bankat presin që niveli i inflacionit do të jetë rreth 1.3 përqind. Pesë nga bankat e anketuara presin që inflacioni do të sillet ndërmjet intervalit 1 dhe 2 përqind, dy nga bankat në anketim presin që inflacioni do të jetë më i lartë se 2 përqind dhe dy banka tjera presin që inflacioni të jetë më i ulët se 1 përqind. Siç ilustron figura 8, shpërndarjet e raportuara të probabilitetit tregojnë një pasiguri relativisht të ulët në lidhje me rezultatin e ardhshëm të inflacionit, pasi shpërndarja e probabilitetit të bankave është e përqendruar në inflacionin e pritur. Në komentet e tyre cilësore, bankat kanë deklaruar se pritjet e tyre rreth dinamikave në shkallën e inflacionit mbështeten në disa faktorë:

- ✓ COVID-19 - Disa nga bankat kanë deklaruar se përderisa masat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për parandalimin e përhapjes së virusit korona pritet të ndikojnë në rënien e aktivitetit ekonomik dhe rrjedhimisht në rënien e nivelit të inflacionit, shkëputjet në zinxhirin e furnizimit mund të ndikojnë në rritjen e nivelit të çmimeve.;
- ✓ Niveli i ulët i prodhimit vendor dhe varësia e lartë nga importet;
- ✓ Dinamikat e çmimeve në tregjet ndërkombëtare;
- ✓ Marrëdhëniet tregtare midis SHBA-së dhe Kinës.

Pritjet e bankave për vitin 2020 janë në përputhje me parashikimet e BQK-së, të cilat sugjerojnë nivel më të ulët të inflacionit gjatë vitit 2020 kundrejt vitit paraprak.

Grafik 8. Probabiliteti i inflacionit për TM2 2020 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komercial dhe kalkulumet e BQK-së.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org